Mal Berisha

A ISHTE “KONFERENCA E RAMBUJESË” PËR PAVARËSINË E KOSOVËS APO PËR AUTONOMINË TITISTE – MILOSHEVIÇIANE TË SAJ?

A ISHTE “KONFERENCA E RAMBUJESË” PËR PAVARËSINË E KOSOVËS APO PËR AUTONOMINË TITISTE – MILOSHEVIÇIANE TË SAJ?

(Disa mendime lidhur me intervistën e Ambasadorit Amerikan në Beograd, Christopher Hill, rreth autonomisë apo pavarësisë së Kosovës)

Që prej shkurtit të vitit 1999, kur Konferenca e Rambujesë i mbylli punimet, ka mbetur pezull një re e errët që rëndon mbi të: A ishte ajo për pavarësinë e Kosovës apo për kthimin e saj në gjendjen e autonomisë së vitit 1974?

Pra, a do të ishte ajo Kosova që shohim sot – e lirë dhe e pavarur – apo do të kthehej në Kosovën e demonstratave të studentëve, të vrasjeve nga policia dhe ushtria terroriste serbo-jugosllave, të burgosjeve, bastisjeve, ekzekutimeve dhe të djemve shqiptarë që kthehesin të "vetëvrarë" nga ushtria në shtëpitë e tyre?

Pikërisht në atë kohë, nëpër Kosovë lëviznin disa emisarë amerikanë që jepnin deklarata publike skandaloze. Njëri prej tyre ishte Gelbard, i cili e quajti UÇK-në një organizatë terroriste. Tjetri ishte ai që më vonë u bë "hero" i Kosovës – i ndjeri Richard Holbrooke. Ky i fundit e ndryshoi opinionin që kishte formuar për shqiptarët vetëm pas një vizite në Deçan, pas 18 orësh bisedimesh të pandërprera me Sllobodan Milosheviçin.

Në atë kohë ka pasur edhe një debat shumë të fortë nëse Partia Demokratike e Shqipërisë ishte kundër Marrëveshjes së Rambujesë apo jo dhe, nëse po, përse ishte kundër saj, në disa pika të marrëveshjes.
Kanë kaluar 23 vjet dhe kësaj pyetje i ka dhënë përgjigje pa asnjë ekuivok ambasadori i sotëm amerikan në Beograd, **Christopher Hill**, i cili në atë kohë ishte negociatori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Rambuje, në një intervistë të dhënë mediave serbe, ku ai shprehet tekstualisht:

> *“Roli im në Rambuje ishte të përpiqesha që Kosovës t’i kthehej shkalla më e lartë e autonomisë që kishte dikur. Rambujeja nuk u mor me pavarësinë e Kosovës; kjo ndodhi më vonë, kur unë nuk isha pjesëmarrës.”*

Ambasadori i sotëm amerikan në Beograd dhe negociatori i asaj kohe në Rambuje e ka thënë qartë, pa lënë asnjë dyshim, se nuk ishte për pavarësinë e Kosovës. Sot, është po ai që nga Beogradi përcjell politikën amerikane në lidhje me Kosovën.

Në këtë mënyrë, e gjithë balta e hedhur kundër atyre që kundërshtuan planet *alla* Christopher Hill dhe Richard Holbrooke për kthimin e Kosovës në një autonomi – që do të nënkuptonte rikthimin e saj nën sovranitetin serb – duhet t’u kthehet në fytyrë atyre që e hodhën atëherë mbi mbrojtësit e vërtetë të Kosovës, të përfaqësuar nga e djathta shqiptare e drejtuar nga Dr. Sali Berisha.

Se çfarë vendimi përmbante teksti i Marrëveshjes Përfundimtare të Rambujesë, e pranuar nga pala shqiptare (dhe jo nga ajo serbe), mjafton të lexohet ky pasazh nga Neni I:

Parimet e Vetëqeverisjes Demokratike në Kosovë

Pika 3 – *Republika Federale e Jugosllavisë mban përgjegjësi në Kosovë për fushat në vijim, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në këtë marrëveshje:*

- (a) integriteti territorial;
- (b) ruajtja e tregut unik brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, pushteti i së cilës do të ushtrohet në mënyrë që të mos diskriminojë Kosovën;
- (c) politika monetare;
- (ç) mbrojtja;
- (d) politika e jashtme;
- (dh) shërbimet doganore;
- (e) tatimet federale;
- (ë) zgjidhjet federale;
- (f) fushat e tjera të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Pika 4 – *Republika e Serbisë do të ketë pushtet në Kosovë, ashtu siç është përcaktuar në këtë marrëveshje, duke përfshirë marrëdhëniet me zgjidhjet republikane.*

Nuk dua të hyj në analizën e asaj që ka thënë ambasadori Hill në atë intervistë, por nuk mund të mos nënvizoj disa prej konstatimeve, të cilat – edhe me një vështrim të thjeshtë –

tregojnë se sa shumë e rëndojnë Kosovën në raport me Serbinë, sidomos në ngjarjet e fundvitit 2022.

1. Ambasadori përkrah barrikadimin e serbëve në veri të Kosovës dhe i konsideron ato si të drejta, “pasi ndërgjegjësuan opinionin ndërkombëtar lidhur me mënyrën se si trajtohen serbët në Kosovë.”
Shënim: Kosova është i vetmi vend në botë që e ka të sanksionuar me ligj trajtimin e minoriteteve përmes konceptit të **“diskriminimit pozitiv.”**

2. Ambasadori nuk iu përgjigj drejtpërdrejt gazetarit serb kur ky i fundit e pyeti dhe bëri një paralele midis bombardimeve të NATO-s në Serbi dhe atyre ruse në Ukrainë.

Është e lehtë për këdo ta bëjë këtë dallim, për dy arsye themelore:

a NATO ndërhyri për të shpëtuar një popull nga gjenocidi serb dhe shfarosja e tij, bazuar tërësisht në vija etnike.
b) NATO nuk goditi asnjë objektiv civil në Serbi, por vetëm caqet ushtarake, ndërsa Rusia godet shkolla, banesa, kopshte, spitale, stacione elektrike, uzina, fabrika dhe çdo objekt tjetër civil.
c) NATO nuk udhëhiqej nga një autokrat apo diktator i vetëm, siç është sot Putini, por nga udhëheqës shtetesh demokratike me qeveri dhe liderë të zgjedhur me vullnetin e lirë të popujve të tyre.

Pra ku është ngjashmëria këtu midis NATO – s, Kosovës, Rusisë dhe Ukrainës?

Ambasadori Hill shpreh keqardhje që gjashtë marrëveshjet e nënshkruara midis Serbisë dhe Kosovës nuk janë zbatuar. Por, a shpreh ai ndonjëherë keqardhje për faktin që **asnjë marrëveshje** e nënshkruar nga Serbia nuk është zbatuar deri më sot?

Ai thotë tekstualisht:

> *"Presidenti Vuçiç, me të cilin kemi një komunikim të mirë, më herët ka deklaruar se, në lidhje me Kosovën, ekzistojnë gjashtë marrëveshje, por partnerët ndërkombëtarë nuk respektojnë asnjërën prej tyre. Ai ka shtuar se, në fakt, ne nuk e dimë se cila është e vlefshme, cila duhet të zbatohet dhe cila është më e rëndësishmja."*

Pra, ambasadori Hill dëgjon me vëmendje një autokrat dhe ish-ministër të Millosheviçit – njeriun që dikur ishte përgjegjës për propagandën e luftës kundër Shteteve të Bashkuara – për çështjen e Kosovës!?

Më tej, ambasadori Hill kërkon zbatimin e marrëveshjes për Bashkësinë e Komunave Serbe në Kosovë dhe e kërkon atë

me ngulm, pavarësisht se sot çdo kërkesë e serbëve përcillet përmes “rojeve të urës” – grupe kriminale të paguara nga Vuçiçi në Beograd.
A do të vijë paqja përmes imponimit të njerëzve të Millosheviçit, si Ivica Daçiç dhe Aleksandër Vuçiç, përmes forcës së armëve dhe barrikadave?

Duke ndjekur me shumë vëmendje këtë intervistë të ambasadorit Christopher Hill, iu riktheva shënimeve të mia të asaj kohe. Për fat, një pjesë e tyre gjenden në librin tim të botuar në vitin 2021, me titull:

"AMBASADOR I PUSHTETIT TË BUTË"

Aty më del qartë se sa qëndrim të drejtë kemi mbajtur atëherë kundër Marrëveshjes së Rambujesë, e udhëhequr nga negociatorët amerikanë në atë konferencë – siç shfaqet sot **autonomisti i Kosovës**, Christopher Hill.
Ja shkrimi im, i cili gjendet në faqet 144, 145 dhe 146 të librit tim:

"KONFERENCA E RAMBUJESË DHE KONTRIBUTI I JOSEPH DIOGUARDI"

Në fillim të vitit 1999 ndodhën ngjarje shumë të rëndësishme për Kosovën. Ndër to veçohen masakra e Reçakut dhe Konferenca e Rambujesë. Bashkësia ndërkombëtare u

angazhua seriozisht për të penguar një gjakderdhje të re në Ballkan.
Në fakt, përvoja e Dayton-it, si marrëveshje paqeje për Bosnjën, kishte lënë një shije shumë të keqe, për shkak të defekteve të jashtëzakonshme që ajo mbartte.

Për më tepër, shqiptarët as që ishin konsideruar në atë rast, ku vetëm Millosheviçi, Izetbegoviçi dhe Tuxhmani ishin palë, të ndërmjetësuara nga amerikanët.
Ajo marrëveshje u nënshkrua edhe nga presidenti amerikan Bill Clinton, kryeministri spanjoll Felipe González, presidenti francez Jacques Chirac, kryeministri britanik John Major, kancelari gjerman Helmut Kohl dhe kryeministri rus Viktor Çernomyrdin.

Ajo marrëveshje solli paqe, por asnjëherë stabilitet në Bosnjë e Hercegovinë.
Por çfarë pritej të sillte konferenca tjetër ndërkombëtare, e cila kishte të njëjtin qëllim – të siguronte paqe në Ballkan, dhe veçanërisht në Kosovën që ndodhej në prag të një shpërthimi të tmerrshëm?

MARRËVESHJA E RAMBUJESË – MË E KEQJA E NËNSHKRUAR NGA SHQIPTARËT DHE E KUNDËRSHTUAR NGA DIOGUARDI

Drafti i Marrëveshjes së Rambujesë, i cili u negociua midis shqiptarëve dhe serbëve me ndihmën e amerikanëve,

veçanërisht të dy diplomatëve Richard Holbrooke dhe Christopher Hill, me gjithë dashamirësinë e tyre, nuk ishte gjë tjetër veçse një lëshim i madh i bashkësisë ndërkombëtare ndaj Millosheviçit.

Dokumenti final linte në fuqi administrimin serb mbi Kosovë, me një autonomi të ngjashme me atë që kishte pasur më herët – pak më e zgjeruar se në kohën e Jugosllavisë titiste – e cila ishte marrë brutalisht nga Millosheviçi në vitin 1989.

Joseph DioGuardi, ashtu si edhe politikanët më atdhetarë shqiptarë, të cilët në atë kohë ishin në opozitë, e kundërshtuan me forcë këtë marrëveshje. Ai doli në ballë të përpjekjeve për ta redaktuar projektin dhe e refuzoi me vendosmëri.

Si politikan profesionist amerikan, ai e kuptonte më mirë se kushdo tjetër se, për Shtetet e Bashkuara dhe Fuqitë e Mëdha, stabiliteti kishte përparësi ndaj realizimit të të drejtave legjitime të shqiptarëve.

Kjo është arsyeja pse diplomatë si Christopher Hill dhe të tjerë iu imponuan shqiptarëve, të cilët në atë kohë nuk kishin asnjë mbështetje tjetër përveç asaj amerikane. Dhe, sado e pamjaftueshme që ishte kjo mbështetje në atë moment, shqiptarët sigurisht nuk mund ta refuzonin.

Në një takim me shumë aktivistë të LQSHA-së, Joseph DioGuardi deklaroi:

> *“Marrëveshja e Rambujesë është marrëveshja e parë në historinë e shqiptarëve, përmes së cilës ata kanë nënshkruar me dorën e tyre të drejtën serbe mbi Kosovën, dhe për pasojë – skllavërimin e mëtejshëm nën sovranitetin serb.”*

Me atë rast, Liga vendosi që Joi dhe Shirley të udhëtonin urgjentisht për në Paris. I përcolla atë natë në Aeroportin “Liberty” në Newark, New Jersey. Ai ngiste një makinë “Cadillac” të thjeshtë. Në vendin e parë ishte ulur Shirley. Vendimi për të udhëtuar ishte marrë menjëherë. Me shpejtësi u bënë gati, morën dosjet, hipëm në veturë dhe DioGuardi e mori vetë timonin.

...Arritëm në terminal në momentin e fundit. Të nesërmen, ata u shfaqën përpara Kështjellës së Rambujesë. Në atë kohë, shumëkush e kundërshtoi qëndrimin e DioGuardit, por nëse edhe sot lexohet me pak vëmendje dokumenti përfundimtar i Marrëveshjes së Rambujesë, del qartë se ai e linte Kosovën në statusin e autonomisë. DioGuardi ishte kundër.

Ajo që ndodhi më pas është ajo që anglezët e quajnë **"by default"**. Ndodhi mrekullia: kryeministri serb, Milutinoviç, nuk e nënshkroi marrëveshjen, por ua hodhi atë

ndërkombëtarëve në fytyrë, pikërisht në çastin kur po linte kështjellën.

Mungesa e një marrëveshjeje solli ndërhyrjen ushtarake të NATO-s, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konsideroj se roli i Joseph DioGuardit ka qenë dhe mbetet historik edhe në këtë moment të rëndësishëm për Kosovën.

Sikur serbët ta kishin nënshkruar marrëveshjen, Kosova do të mbetej me statusin e një autonomie nën pushtetin serb. Në dokument përmendej një autonomi me të drejtë referendumi pas tre vjetësh – por, a do të mund të arrihej vërtet kjo?

A ishin serbët tradhtarë të çështjes së tyre në Rambuje? A ishin ata tradhtarë, për faktin se nuk e pranuan një zgjidhje që kishte pasoja minimale për ta, por nuk u jepte asgjë shqiptarëve?
Kjo mbetet një pikëpyetje e madhe.

A ishin ata agjentë të shitur apo naivë? Këtë ende nuk e ka vlerësuar historia.
E vërteta është se situata nuk mbante më: serbët nuk nënshkruan, ndërsa shqiptarët pranuan një dokument – ndoshta me premtime të strukturave të fshehta – që do t'i bëjë të skuqen gjithë jetën.

Megjithatë, kokëfortësia serbe dhe “toleranca” shqiptare i shkuan për shtat zgjidhjes së çështjes së Kosovës, pra – fillimit të luftës.

Joseph DioGuardi ishte në anën e së drejtës. Por, a ishte edhe në anën e historisë?
Kjo mbetet një çështje që kërkon diskutim.

Ky është konstatimi im i asaj kohe – dhe ky është edhe vërtetimi se Christopher Hill ka qenë atëherë, dhe mbetet edhe sot, njeriu që e ka dashur dhe e do Kosovën nën sovranitetin serb!

Kujdes, vëllezër shqiptarë të Kosovës!
“**Diçka po zihet**” – por jo te emisioni televiziv i RTV21, por në kulisat e interesave anti-Kosovë!